Deri në miratimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, që përcaktojnë klasën dhe grupin të cilit i përket një pozitë pune të Ligjit përkatës të Pagave, paga bazë për nëpunësit civil llogaritet sipas ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të përcaktuar me Vendim nga Qeveria e Kosovës, pas propozimit së Ministrisë përgjegjëse për Administratë Publike dhe Ministrisë përgjegjëse për Financa.

job catalogue no later than nine (9) months from the entry into force of this Regulation.

2. Regulations for the internal organization and systematization of jobs, which determine the class and group to which one job position of a professional category belongs, shall be adopted no later than nine (9) months from the entry into force of this Regulation.

Article 30
Transitional provisions on salaries

Until the approval of the Regulation on internal organization and systematization of jobs, which defines the class and group to which a job position belongs, and the relevant Law on Salaries, the basic salary for civil servants is calculated according to the equivalence of the old system with the new system of classification determined by a decision of the Government of Kosovo, upon proposal of the ministry responsible for public administration and the ministry responsible for finance.

radnih mesta ne kasnije od devet (9) meseci od stupanja na snagu ove Uredbe.

2. Uredbe za unutrašnju organizaciju i sistematizaciju radnih mesta, koje određuju klasu i grupu kojoj pripada jedna radna pozicija profesionalne kategorije, usvajaju se ne kasnije od devet (9) meseci od stupanja na snagu ove Uredbe.

Član 30
Prelazna odredba o platama

Do usvajanja Uredbe o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta, koja utvrđuje klasu i grupu kojoj pripada radno mesto, i relevantnog zakona o platama, osnovna plata za civilne službenike obračunava se prema ekvivalentnosti starog sistema sa novim sistemom klasifikacije, koja je utvrđena odlukom Vlade Kosova, nakon predloga nadležnog ministarstva za javnu upravu i nadležnog ministarstva za finansije.

| | | |
|---|--|---|
| <p style="text-align: center;">Neni 31 Dispozita kalimtare për katalogun e vendeve të punës</p> <p>1. Brenda tre (3) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, katalogu i vendeve të punës hartohet dhe miratohet në pajtim me këtë Rregullore nga Qeveria, me propozim të Ministrisë përgjegjëse për Administratë Publike dhe Ministrisë përgjegjëse për Financa përmes një komisioni të përbashkët prej pesë (5) deri në shtatë (7) anëtarë të themeluar nga Qeveria.</p> <p>2. Kur paraqitet nevoja për përditësimin e katalogut sipas paragrafit 1 të këtij neni, përditësimi miratohet nga Ministri përgjegjës për Administratë Publike pas propozimit të DMZP.</p> | <p style="text-align: center;">Article 31 Transitional provisions on the the job catalogue</p> <p>1. Within three (3) months upon entry into force of this Regulation, the job catalogue shall be drafted and approved by the Government, in accordance with this regulation, upon proposal of the Ministry responsible for public administration and the Ministry responsible for finance through a joint commission composed of five (5) to seven (7) members, established by the Government.</p> <p>2. When the need arises to update the catalogue according to paragraph 1 of this article, the update shall be approved by the minister responsible for public administration upon proposal of the DMPO.</p> | <p style="text-align: center;">Član 31 Prelazna odredba o katalogu radnih mesta</p> <p>1. U roku od tri (3) meseca od stupanja na snagu ove uredbe, Vlada sačinjava i odobrava katalog radnih mesta u skladu sa ovom uredbom, na predlog Ministarstva nadležnog za javnu upravu i Ministarstva nadležnog za finansije putem zajedničke komisije od pet (5) do sedam (7) članova koju je osnovala Vlada.</p> <p>2. Kada postoji potreba za ažuriranjem kataloga u skladu sa stavom 1. ovog člana, ažuriranje odobrava ministar nadležan za javnu upravu na predlog OUJS-a.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 32 Dispozita kalimtare për grupimin</p> <p>Deri në miratimin e Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, që përcakton grupin të cilit i përket një pozitë pune, grupi të cilës i përket një pozitë, përcaktohet rast pas rasti nga</p> | <p style="text-align: center;">Article 32 Transitional provisions on grouping</p> <p>Until the approval of the Regulation on Internal Organization and Systematization of Job Positions, which defines the group to which one job position belongs, the group to which a position belongs is determined on a case-by-case basis by the</p> | <p style="text-align: center;">Član 32 Prelazna odredba za grupisanje</p> <p>Do usvajanja Uredbe za unutrašnju organizaciju i sistematizaciju radnih mesta, koja određuje grupu kojoj pripada jedna radna pozicija, grupa kojoj pripada jedna pozicija se određuje slučaj po slučaj od strane Odogovorne jedinice za regrutovanje.</p> |

| | | |
|---|---|--|
| <p>Njësia Përgjegjëse për Pranim.</p> <p style="text-align: center;">Neni 33 Dispozita kalimtare për nëpunësit civil aktual</p> <p>Një nëpunës civil i cili aktualisht është i vendosur në një klasë dhe nuk posedon nivelin dhe llojin e arsimimit të përcaktuar për atë klasë, sipas kësaj Rregulloreje, vazhdon të mbaj pozitën nëse së paku tri vitet e fundit ka vlerësim pozitiv të rezultateve në punë. I njëjti mund të aplikoj për lëvizje brenda kategorisë dhe ngritje në detyrë, vetëm kur e plotëson kriterin e nivelit dhe llojin përkatës të arsimit që përcaktohet me këtë Rregullore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 34 Dispozitat shfuqizuese</p> <p>Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë Rregullore.</p> | <p>responsible Admission Unit.</p> <p style="text-align: center;">Article 33 Transitional provisions on current civil servants</p> <p>A civil servant who is currently placed in a class and does not possess the level and type of education defined for that class under this Regulation shall continue to hold the position if for at least the last three years they have had a positive performance assessment. The same can apply for transfer within the category and promotion only when they meet the criteria of the relevant level and type of education defined by this regulation.</p> <p style="text-align: center;">Article 34 Repealing provisions</p> <p>Entry into force of this Regulation shall abrogate Regulation No. 26/2020 on the Classification of Jobs in Civil Service and any provisions that are inconsistent with this Regulation.</p> | <p style="text-align: center;">Član 33 Prelazne odredbe za aktuelne civilne službenike</p> <p>Civilni službenik koji je trenutno smešten u jednu klasu i ne poseduje nivo i vrstu obrazovanja koja je utvrđena za tu klasu, u skladu sa ovom uredbom, nastavlja da drži poziciju ako najmanje u poslednje tri godine ima pozitivno ocenjivanje rezultata rada. Isti može da aplicira za kretanje unutar kategorije i unapređenje samo ako ispunjava kriterijum relevantnog nivoa i vrste obrazovanja, koje su utvrđene ovom Uredbom.</p> <p style="text-align: center;">Član 34 Odredbe ukidanja</p> <p>Stupanjem na snagu ove Uredbe, stavlja se van snage Uredba br. 26/2020 o klasifikaciji radnih mesta u civilnoj službi kao i svaka odredba koja je u suprotnosti sa ovom Uredbom.</p> |
|---|---|--|

**Neni 35
Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare.

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës

30 dhjetor 2022

**Article 35
Entry into force**

This Regulation shall enter into force on the day of its publication on the Official Gazette.

Albin Kurti

Prime Minister of the Republic of Kosovo

30 December 2022

**Član 35
Stupanje na snagu**

Ova Uredba stupa na snagu na dan objavljivanja na Službenom Listu.

Albin Kurti

Premijer Republike Kosovo

30 decembar 2022

SHTOJCA NR. 1: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për secilën klasë në shërbimin civil të Kosovë

Shtojca Nr.1/1: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Drejtues i Lartë 1 (në institucionet politikëbërëse).

Drejtues i Lartë 1

Është udhëheqësi më i lartë administrativ (nëpunës civil) në institucion, i cili për punën e tij i përgjigjet drejtpërdrejtë titullarit të institucionit.

Përfshin pozitat me këto emërtesa:

1. Sekretar i Përgjithshëm në Presidencë;
2. Sekretar i Përgjithshëm në Zyrë të Kryeministrit;
3. Sekretar i Përgjithshëm në Ministri;
4. Drejtor i Përgjithshëm/Drejtor Ekzekutiv në Agjenci dhe institucione të pavarura;
5. Drejtor i Përgjithshëm në Agjenci Rregullatore.

I. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Mbështet dhe ofron këshilla për titullarin e institucionit në përcaktimin e politikave, strategjive dhe objektivave të institucionit dhe zhvillimit të tyre.
- Siguron koordinimin dhe hartimin e politikave, objektivave si dhe hartimin dhe zhvillimin e programeve, procedurave përkatëse dhe standardeve për zbatimin e tyre.
- Miraton plane pune, plane veprimi, si dhe iniciativa për arritjen e objektivave në periudha afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, si dhe organizon punën dhe përcakton detyrat sipas njësisve kryesore administrative.
- Koordinon dhe garanton përfshirjen e kontributeve të dhëna nga Departamentet dhe/ose strukturat tjera të institucionit gjatë procesit të hartimit të politikave dhe strategjive sipas fushës së përgjegjësisë.
- Siguron zbatimin e legjislacionit, politikave dhe vendimeve të titullarit të institucionit, si dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme dhe komplekse, që ndikojnë në realizimin e objektivave të institucionit.
- Siguron përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit për realizimin e

II. Karakteristikat sipas faktorëve të klasifikimit:

- **Niveli i rëndësisë** - përfshin përgjegjësinë për detyrat dhe vendimet me ndikim të rëndësishëm në përcaktimin dhe zbatimin e politikave, duke përfshirë përgjegjësi të gjerë mbikëqyrëse dhe menaxheriale.
- **Niveli i lirisë në vendimmarrje** - përfshin pavarësinë në punë dhe vendimmarrje mbi çështjet e ndërlikuara profesionale duke e kufizuar vetëm me udhëzimet e përgjithshme lidhur me politikën shtetërore dhe politikën e miratuara të institucionit.
- **Niveli i vështirësisë** - përfshin zhvillimin e koncepteve të reja dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme dhe komplekse që ndikojnë në realizimin e objektivave institucionale, si dhe planifikimin, menaxhimin dhe koordinimin e detyrave të besuara.

politikave, synimeve dhe objektivave të institucionit dhe siguron një sistem efikas të kontrollit të brendshëm financiar, si dhe identifikon mundësitë për reduktim të shpenzimeve.

- Menaxhon nëpunësit civil dhe punonjësit e tjerë të institucionit dhe vendos politika dhe programe për administrimin, përzgjedhjen, trajnimin, stimulimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, si dhe udhëheqjen dhe menaxhimin e tyre.
- Përfaqëson institucionin me autorizim të titullarit të institucionit në takime dhe forume brenda dhe jashtë vendit në fushat dhe çështjet e ndërlidhura me mandatet dhe funksionet e institucionit.
- Kryen çdo detyrë dhe përgjegjësi tjetër që i caktohet me ligj apo i delegohet shprehimisht nga titullari i institucionit.

III. Kërkesat (Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë) e përgjithshme të nevojshme:

- Aftësi të larta organizative, drejtuese (leadership) të hartimit të politikave dhe menaxhimit strategjik.
- Shkathtësi të shkëlqyera strategjike dhe analitike që i mundësojnë të këshilloj për çështje komplekse, me besueshmëri dhe vendosshmëri në arritjen e objektivave strategjike të institucionit.
- Aftësi për të udhëhequr, bashkëpunuar dhe për të menaxhuar ndryshime të rëndësishme në organizata të mëdha dhe komplekse.
- Njohuri të gjëra lidhur me fushën e përgjegjësisë së institucionit, menaxhimit buxhetor dhe të shërbimit civil.
- Aftësi për t'iu përshtatur ndryshimeve të prioritetëve, kërkesave dhe afateve kohore përmes aftësive të nivelit të lartë analitik dhe zgjidhjes së problemeve.
- Aftësi të forta negociimi, komunikimi dhe bashkëpunimi, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie mirëbesimi me titullarin e institucionit dhe stafin që menaxhon.

IV. Kërkesat e përgjithshme formale:

- a) **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 4 vite të studimeve.
- b) **Kualifikime të posaçme formale:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase.
- c) **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese.

Shtojca Nr.1/2: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Drejtues i Lartë 2 (në institucionin, veprimtaria e të cilit përqendrohet në zbatimin e drejtpërdrejtë të ligjit ose ofrimin e shërbimeve të caktuara).

Drejtues i Lartë 2

Është udhëheqësi më i lartë administrativ (nëpunës civil dhe nëpunës i shërbimit publik) në Agjenci Ekzekutive, i cili për punën e tij i përgjigjet titullarit të institucionit.

Përfshinë pozitat me këto emërtesa:

1. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Ekzekutive.
2. Drejtor Ekzekutiv ose Sekretar i Përgjithshëm i Institucionit të Administratës së Shërbimit Publik.

I. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Mbështet dhe ofron këshilla të nivelit të lartë për titullarin e institucionit dhe Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me fushëveprimtarinë e Agjencisë Ekzekutive/Institucionit të Administratës së Shërbimeve Publike.
- Drejton dhe mbikëqyrë të gjitha aktivitetet e Agjencisë/Institucionit të Administratës së Shërbimeve Publike dhe siguron funksionimin efikas të saj, si dhe menaxhon nëpunësit civil dhe punonjësit e tjerë të Agjencisë.
- Siguron zbatimin e legjislacionit, vendimeve që ndërlidhet me Agjencinë/Institucionin e Administratës së Shërbimeve Publike, si dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme dhe komplekse, që ndikojnë në realizimin e objektivave të Agjencisë.
- Propozon buxhetin për Agjencinë/Institucionin e Administratës së Shërbimeve Publike dhe siguron ekzekutimin e tij sipas legjislacionit për menaxhimin e financave publike, si dhe identifikon mundësitë për reduktim të shpenzimeve.
- Harton planin e punës, plane veprimi dhe raportin vjetor të performancës së Agjencisë/Institucionit të Administratës së Shërbimeve Publike.
- Organizon punën dhe përcakton detyrat sipas Departamenteve

II. Karakteristikat sipas faktorëve të klasifikimit:

- **Niveli i rëndësisë** - përfshin përgjegjësinë për detyrat dhe vendimet me ndikim të rëndësishëm për Agjencinë, duke përfshirë përgjegjësi të gjërë mbikëqyrëse dhe menaxheriale.
- **Niveli i lirisë së vendimmarrjes** - përfshinë pavarësinë në punë dhe vendimmarrje, duke u kufizuar vetëm me udhëzimet e përgjithshme të udhëheqësve që janë në pozitë më të lartë hierarkike.
- **Niveli i vështirësisë** – përfshin pjesëmarrjen në zhvillimin e koncepteve të reja dhe zgjidhjen e problemeve brenda fushës së Agjencisë, që ndikojnë në rezultatet përfundimtare.

| | |
|--|---|
| <p>dhe siguron një klimë bashkëpunimi dhe gjithëpërfshirëse të stafit dhe promovon zhvillimin e kapaciteteve njerëzore.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përfaqëson Agjencinë/Institucionin e Administratës së Shërbimeve Publike me autorizim të titullarit të institucionit në takime dhe forume brenda dhe jashtë vendit në fushat dhe çështjet e ndërlidhura me mandatet dhe funksionet e Agjencisë. ▪ Kryen edhe çdo detyrë dhe përgjegjësi tjetër që i caktohet me ligj apo i delegohet shprehimisht nga titullari i institucionit. | |
| <p>III. <u>Kërkesat (Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë) e përgjithshme të nevojshme:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Aftësi të larta organizative, drejtuese dhe menaxhim strategjik; ▪ Aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve, kërkesave dhe afateve kohore përmes aftësive të nivelit të lartë analitik dhe zgjidhjes së problemeve. ▪ Njohuri të gjëra lidhur me fushën e përgjegjësisë së Agjencisë/Institucionit, menaxhimin e sistemit buxhetor dhe të shërbimit civil. ▪ Aftësi të forta negocimi, komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie besimi me titullarin e institucionit dhe stafin që menaxhon. ▪ Aftësi për të motivuar stafin dhe për të menaxhuar me sukses një sërë projektesh të Agjencisë. | <p>IV. Kërkesat e përgjithshme formale:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 4 vite të studimeve. b) Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase. c) Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese. |

Shtojca Nr.1/3: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Drejtues i Lartë 3.

Drejtues i Lartë 3

Është zyrtar (nëpunës civil, nëpunës i shërbimeve publike) i nivelit të lartë drejtues në Agjenci të Pavarura, Rregullatore dhe Ekzekutive të përcaktuara me ligje të themelimit, i cili punon nën drejtimin e Drejtorit të Përgjithshëm/Ekzekutiv dhe ndihmon për të udhëhequr Agjencinë dhe menaxhuar aktivitetet e përditshme të saj, si dhe zëvendëson Drejtorin gjatë periudhës së mungesës së tij. Për punën e tij i përgjigjet Drejtorit të Përgjithshëm/Ekzekutiv.

Përfshinë pozitat me këto emërtesa:

1. Zëvendës drejtor Ekzekutiv në një Agjenci të Pavarur, Rregullatore dhe Ekzekutive.

I. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Ofron këshilla dhe rekomandime profesionale për Drejtorin e Përgjithshëm/Ekzekutiv dhe titullarin e institucionit mbi detyrat operative strategjike dhe ditore, duke përfshirë implikimet e vendimeve kryesore të politikave, resurseve dhe performancës së Agjencisë.
- Ndihmon Drejtorin e Përgjithshëm/Ekzekutiv në drejtimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të Agjencisë, si dhe zhvillimin e politikave operative për funksionim efikas.
- Kontribuon në zhvillimin dhe zbatimin e planeve dhe vendimeve strategjike të Drejtorit të Përgjithshëm/Ekzekutiv dhe arritjen e objektivave të Agjencisë dhe rezultateve në ofrimin e shërbimeve.
- Zëvendëson Drejtorin Ekzekutiv gjatë periudhave të mungesës së tij dhe lidhur me çështjet që i delegohen nga Drejtori i Përgjithshëm/Ekzekutiv dhe siguron që vendimet të përputhen me objektivat e Agjencisë.
- Nën menaxhimin e Drejtorit të Përgjithshëm/Ekzekutiv mbikëqyr zbatimin e objektivave të Agjencisë dhe realizimin e projekteve dhe ofrimin e shërbimeve.
- Ndihmon në përgatitjen e buxhetit, planit të punës dhe raportit

II. Karakteristikat sipas faktorëve të klasifikimit:

- **Niveli i rëndësisë** - përfshin përgjegjësinë për detyrat dhe vendimet që lidhen me Agjencinë Ekzekutive.
- **Niveli i lirisë së vendimmarrjes** - përfshinë pavarësinë në punë dhe vendimmarrje, duke u kufizuar vetëm me udhëzimet e përgjithshme të udhëheqësve që janë në pozitë më të lartë hierarkike.
- **Niveli i vështirësisë** – përfshin pjesëmarrjen në krijimin dhe zhvillimin e koncepteve të reja dhe zgjidhjen e problemeve dhe detyrave të rëndësishme.

| | |
|--|---|
| <p>vjetor të performancës së Agjencisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndhmon në zbatimin e praktikave më të mira të udhëheqjes, menaxhimit, procedurave organizative, zhvillimit të stafit, menaxhimit financiar dhe parimeve të menaxhimit të riskut. ▪ Kryen çdo detyrë dhe përgjegjësi tjetër që i caktohet me ligj apo i delegohet shprehimisht nga Drejtori i Përgjithshëm/Ekzekutiv. | |
| <p><u>III. Kërkesat (Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë) e përgjithshme të nevojshme:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Aftësi të larta organizative, drejtuese dhe menaxhim strategjik. ▪ Aftësi për t’ju përshtatur prioriteteve, kërkesave dhe afateve kohore përmes aftësive të nivelit të lartë analitik dhe zgjidhjes së problemeve. ▪ Njohuri të gjëra lidhur me fushën e përgjegjësisë së Agjencisë, menaxhimin e sistemit buxhetor dhe të shërbimit civil. ▪ Aftësi negocimi, komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie, besimi me titullarin e institucionit dhe stafin që menaxhon. ▪ Aftësi për të motivuar stafin dhe për të menaxhuar me sukses një sërë projektesh të Agjencisë. | <p><u>IV. Kërkesat e përgjithshme formale:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 4 vite të studimeve. b) Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase. c) Përvoja e punës së kërkuar: Së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese. |

Shtojca Nr.1/4: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Drejtues i Mesëm (institucionet politikëbërëse).

Drejtues i Mesëm

Është përgjegjës për menaxhimin e një Departamenti i cili është përgjegjës për formulimin, mbikëqyrjen e zbatimit të politikave, legjislacionit, dokumenteve strategjike, procedurave, standardeve që kanë shtrirje në të gjitha institucionet e nivelit qendror dhe lokal, ose koordinimin e proceseve të rëndësishme shtetërore. Gjithashtu, për fushat të cilat i menaxhon është përgjegjës për hartimin e raporteve për Qeverinë dhe Kuvendin. Mbajtësi i kësaj pozite është nëpunës civil dhe për punën e tij i përgjigjet drejtpërdrejtë udhëheqësit më të lartë administrativ të institucionit.

Përfshin pozitat me këto emërtesa:

1. Drejtor Departamenti në Presidencë;
2. Drejtor Departamenti në Zyrën e Kryeministrit;
3. Drejtor Departamenti në një Ministri;
4. Drejtor Departamenti në një institucion kushtetues të pavarur;
5. Drejtor i Departamentit në Agjenci të Pavarur dhe në Agjenci Rregullatore;
6. Drejtor i Departamentit në Agjenci Ekzekutive dhe Institucione të Administratës së Shërbimit Publik.

I. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Mbështet dhe ofron këshilla për udhëheqësin më të lartë administrativ të institucionit dhe/ose titullarin e institucionit për politikën dhe objektivat e institucionit në fushën e përgjegjësisë së Departamentit.
- Identifikon nevojat për zhvillimin e politikave dhe objektivave të institucionit dhe bën rekomandime brenda përgjegjësisë së Departamentit.
- Drejton dhe mbikëqyr të gjitha aktivitetet e Departamentit dhe siguron funksionim efikas të tij.
- Është përgjegjës për përcaktimin e objektivave dhe planifikimin e veprimtarisë së Departamentit dhe zgjidhjen e problemeve profesionale që lidhen me Departamentin.
- Menaxhon me burimet njerëzore dhe buxhetin e Departamentit, si dhe identifikon nevojat për ngritjen e

II. Karakteristikat sipas faktorëve të klasifikimit:

- **Niveli i rëndësisë** - përfshin përgjegjësinë për zbatimin e duhur të metodologjisë së punës, procedurat dhe teknikat profesionale dhe përgjegjësinë për menaxhimin e njësive përkatëse organizative.
- **Niveli i lirisë së vendimmarrjes** - përfshin pavarësinë në punë që kufizohet nga mbikëqyrja e kohëpaskohshme e eprorit dhe ndihmën e tij në zgjidhjen e problemeve komplekse profesionale.
- **Niveli i vështirësisë** – përfshin sigurimin e mbështetjes për pozitat e larta drejtuese për të siguruar zbatimin e duhur të masave dhe udhëzimeve për adresimin e detyrave strategjike të rëndësishme.

| | |
|---|--|
| <p>kapaciteteve të stafit të Departamentit.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Organizon dhe shpërndan punën për varësit e tij dhe menaxhon realizimin e detyrave dhe përgjegjësiqe që duhen përmbushur në përputhje me objektivat dhe përgjegjësitë e Departamentit. ▪ Udhëzon stafin në përmbushjen e aktiviteteve të përditshme të Departamentit dhe siguron që kjo veprimtari të jetë në përputhje me legjislacionin, politikat institucionale dhe standardet përkatëse. ▪ Me autorizimin e mbikëqyrësit, përfaqëson institucionin në takime pune, konferenca në fushën e përgjegjësisë së Departamentit të cilin e udhëheq. ▪ Bën vlerësimin e rezultateve në punë për stafin nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të tij dhe identifikon nevojat për zhvillimin e kapaciteteve të tyre përmes trajnimeve. | |
| <p><u>III. Kërkesat (Njohuritë, aftësië dhe cilësitë) e përgjithshme të nevojshme:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Aftësi të larta organizative, drejtuese dhe për hartim politikash. ▪ Aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive të nivelit të lartë analitik dhe zgjidhjes së problemeve. ▪ Njohuri të gjëra lidhur me fushën e përgjegjësisë së Departamentit, menaxhimin e buxhetit dhe të shërbimit civil. ▪ Aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie mirëbesimi me eprorin dhe stafin që e menaxhon. ▪ Aftësi për të motivuar stafin dhe për të menaxhuar me sukses projektet e Departamentit. | <p><u>IV. Kërkesat e përgjithshme formale:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 4 vite të studimeve. b) Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase. c) Përvoja e punës e kërkuar: Së paku gjashtë (6) vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku tri (3) vite në pozita drejtuese. |

Shtojca Nr.1/5: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Drejtues i Ultë.

Drejtues i Ultë

Në këtë klasë vendoset Udhëheqësi i një Divizioni i cili është përgjegjës për fushën e caktuar të përgjegjësisë brenda Departamentit ose institucionit. Mbajtësi i kësaj pozite është nëpunës civil i cili për punën e tij i përgjigjet drejtpërdrejtë Drejtorit të Departamentit ose udhëheqësit më të lartë administrativ.

Pavarësisht përcaktimeve të kësaj kategorie, për qëllim të klasifikimit pozita e certifikuesit konsiderohet si pozitë ekuivalente me drejtuesin e ultë në institucionin përkatës. Detyrat dhe përgjegjësitë e certifikuesit përcakthen me legjislacionin relevant në fuqi.

Përfshin pozitat me këto emërtesa:

1. Udhëheqës i Divizionit në Presidencë;
2. Udhëheqës i Divizionit në Zyrën e Kryeministrit;
3. Udhëheqës i Divizionit në një Ministri;
4. Udhëheqës i Divizionit në një Institucion Kushtetues të Pavarur;
5. Udhëheqës i Divizionit në Agjenci të Pavarur dhe në Agjenci Rregullatore.
6. Udhëheqës i Divizionit/Sektorit në Agjenci Ekzekutive, Komunë dhe Institucion të Administratës së Shërbimeve Publike.

I. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Mbështet dhe ofron këshilla për drejtorin e Departamentit dhe sipas kërkesës për udhëheqësin më të lartë administrativ të institucionit dhe titullarin e institucionit për fushën e përgjegjësisë së Divizionit që udhëheqë.
- Drejton dhe mbikëqyrë të gjitha aktivitetet e Divizionit dhe siguron funksionim efikas të tij, si dhe ndihmon Drejtorin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave.
- Kontribuon në procesin e vendimmarrjes sipas fushës së

II. Karakteristikat sipas faktorëve të klasifikimit:

- **Niveli i rëndësisë** - përfshin përgjegjësinë për menaxhimin e njësive përkatëse organizative në kuadër të departamentit ose institucionit.
- **Niveli i lirisë së vendimmarrjes** - përfshin pavarësinë në punë që kufizohet nga mbikëqyrja e shpeshtë e mbikëqyrësit dhe ndihmën e tij në zgjidhjen e problemeve komplekse profesionale.
- **Niveli i vështirësisë** – përfshin mbështetjen e zyrtarëve profesional në zgjidhjen e detyrave komplekse.

përgjegjëse, duke siguruar të dhëna të detajuara dhe analizave të cilat mbështesin procesin e vendimmarrjes.

- Planifikon, përgatit, monitoron dhe analizon buxhetin e Divizionit si dhe aktivitetet tjera të Divizionit dhe siguron përmbushjen e tyre sipas planit.
- Organizon dhe shpërndan punën për stafin të tij dhe menaxhon realizimin e detyrave dhe përgjegjëse që duhen përmbushur në përputhje me objektivat dhe përgjegjësitë e Divizionit.
- Udhëzon stafin në përmbushjen e aktiviteteve të përditshme dhe siguron që kjo veprimtari të jetë në përputhje me legjislacionin, politikat institucionale dhe standardet përkatëse.
- Me autorizimin e mbikëqyrësit, përfaqëson institucionin në takime pune, konferenca në fushën e përgjegjësisë së Divizionit të cilin e udhëheqë.
- Siguron komunikimin brenda dhe jashtë njësisë organizative dhe institucionit me qëllim të mbledhjes ose shkëmbimit të informacionit.
- Bën vlerësimin e rezultateve të punës për stafin nën mbikëqyrje të tij dhe identifikon nevojat për ngritjen e kapaciteteve të tyre.

III. Kërkesat (Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë) e përgjithshme të nevojshme:

- Njohuri të gjëra e të thella të politikave, legjislacionit, procedurave sipas veprimtarisë që mbulon Divizioni.
- Aftësi organizative dhe drejtuese për të menaxhuar njësi organizative.
- Aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive analitike dhe zgjidhjes së problemeve.
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie besimi me eprorin dhe stafin që e menaxhon.
- Aftësi për të motivuar stafin dhe për të menaxhuar me sukses Projektet e Divizionit/Departamentit.

IV. Kërkesat e përgjithshme formale:

- a) Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve.
- b) Kualifikime të posaçme formale:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase.
- c) Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.

Shtojca Nr.1/6: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Profesional 1.

Profesional 1

Në këtë klasë vendosen pozitat e nivelit të lartë profesional, të cilat kryejnë detyra që kërkojnë njohuri të thella profesionale në fushat dhe sektorët e caktuar. Mbjtësit e këtyre pozitave kryejnë një sërë detyrash të natyrës komplekse ose specifike në mënyrë individuale ose si udhëheqës ose anëtar i një ekipi. Mbjtësit e këtyre pozitave punojnë të pavarur dhe pa mbikëqyrje dhe mbështetje profesionale brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave.

Përfshin pozitat me këto emërtesa:

Emërtesat e pozitave për këtë klasë përcaktohen në pajtim me Katalogun e Vendeve të Punës.

I. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Kjo klasë përfshin pozita për realizimin e detyrave të cilave nevojiten njohuri të thella profesionale të fushës përkatëse.
- Puna kryhet brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave.
- Detyrat/Projektet realizohen në përputhje me politikat e institucionit, me standardet administrative dhe procedurat teknike, si dhe duke mbajtur parasysh praktikat profesionale.
- Përmbushja e detyrave kërkon aftësi analitike dhe planifikim të pavarur.
- Nga zyrtarët e kësaj klase kërkohet dhe pritët të identifikojnë mundësitë për përmirësimin e mëtejshëm të procedurave dhe teknikave.
- Nga zyrtarët e kësaj klase kërkohet dhe pritët të diskutojnë rezultatet e punës me eprorin e tyre dhe t'i referohen atij vetëm në rastet e problematikave/çështjeve jo të zakonshme.
- Eprori kontrollon punën e zyrtarit të kësaj klase, vetëm sa i takon rezultatit dhe zakonisht nuk ndërhyr lidhur me përmbajtjen e saj.
- Zyrtari i kësaj klase udhëzon stafin në pozita ta klasave më të ultë brenda njësisë organizative për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësisë të tyre.
- Sipas nevojës, rishikon dhe kontrollon punën e zyrtarëve të tjerë profesional të nivelit më të ultë, duke sugjeruar dhe udhëzuar kryerjen e punëve profesionale.

II. Karakteristikat sipas faktorëve të klasifikimit:

- **Niveli i rëndësisë** - përfshin përgjegjësinë për marrjen e vendimeve që ndikojnë në punën e njësisë organizative. Përfshihen, kontribuojnë dhe kontrollojnë vendim-marrjen që si rregull ka pasoja kombëtare por përfshin edhe raste individuale.
- **Niveli i lirisë së vendimmarrjes** - përfshin kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisë në përputhje me udhëzimet e përgjithshme të udhëheqësit të tij dhe me një shkallë të konsiderueshme autonomie dhe vetë-iniciative.
- **Niveli i vështirësisë** – përfshin, procese pune që paraqesin kompleksitet të lartë dhe nevojë për inovacion, si dhe mbështetjen profesionale për nëpunësit civil të nivelit më të ultë dhe mbikëqyrësit e tij në çështjet brenda fushës së përgjegjësisë së tij.

III. Kërkesat (Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë) e përgjithshme të nevojshme:

- Njohuri të thella dhe të specializuara në fushën profesionale specifike.
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë.
- Njohuri të gjëra të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike.
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës.
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave.
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale.
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- Njohja e gjuhës angleze.

IV. Kërkesat e përgjithshme formale:

- a) **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për profesione deficitare (TIK);
- b) **Kualifikime të posaçme formale:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase.
- c) **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Shtojca Nr.1/7: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Profesional 2.

Profesional 2

Në këtë klasë vendosen pozitat e nivelit profesional në gjithë shërbimin civil, të cilat kryejnë detyra që kërkojnë njohuri të përgjithshme profesionale në fusha të caktuara. Puna kryhet brenda udhëzimeve specifike dhe praktikave të institucionit me një shkallë të arsyeshme të pavarësisë me mbikëqyrje dhe mbështetje profesionale të kohëpaskohshme nga mbikëqyrësi dhe zyrtari i nivelit profesional më i lartë profesional.

Përfshin pozitat me këto emërtesa:

Emërtesat e pozitave për këtë klasë përcaktohen në pajtim me Katalogun e Vendeve të Punës.

I. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Kjo klasë përfshin pozita për realizimin e detyrave të cilave nevojiten njohuri të plota të një fushe të caktuar.
- Përmbushja e detyrave në pozitat e kësaj klase realizohet duke ndjekur udhëzimet dhe praktikën institucionale.
- Kërkohet që gjatë punës në pozitat e kësaj klase të zhvillohet një analizë e kujdesshme e informacionit faktik.
- Zyrtarët në pozitat e kësaj klase mund të përshtatin procedurat, teknikat, mjetet materiale dhe /ose pajisjet me nevojat e fushës së veprimtarisë dhe mund të kryejnë punë të cilat nuk janë rutinë por gjithmonë brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë.
- Zyrtari në pozitat e kësaj klase merr përgjegjësi specifike, pa mbikëqyrje, për interpretimin dhe zbatimin e një numri të procedurave dhe udhëzimeve administrative përmes vetë iniciativës kur kërkohet një gjë e tillë.

II. Karakteristikat sipas faktorëve të klasifikimit:

- ***Niveli i rëndësisë*** - përfshin përgjegjësinë në marrjen e vendimeve që ndikojnë në punën e njësisë organizative. Përfshihen apo kontribuojnë në vendimmarrje që si rregull nuk ka pasoja kombëtare por kufizohet në pasoja brenda institucionit.
- ***Niveli i lirisë së vendimmarrjes*** - përfshin punën nën mbikëqyrje të zakonshme, jo të rregullt për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë duke ndjekur udhëzimet e përgjithshme dhe specifike të epërorit/mbikëqyrësit.
- ***Niveli i vështirësisë*** – përfshin, procese pune që paraqesin kompleksitet të mesëm dhe nevojë të moderuar për inovacion.

III. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësitë) e përgjithshme të nevojshme:

- Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike.
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë.
- Njohuri të mira të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve.
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës.
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave.
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale.
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- Njohja e gjuhës angleze.

IV. Kërkesat e përgjithshme formale:

- a) Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për profesione deficitare (TIK);
- b) Kualifikime të posaçme formale:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase.
- c) Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku 1(një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Shtojca Nr.1/8: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Profesional 3.

Profesional 3

Në këtë klasë vendosen pozitat e nivelit profesional në gjithë shërbimin civil, të cilat kryejnë detyra administrative, mbështetëse për zyrtarët e tjerë profesionale të cilat kërkojnë njohuri të fituara përmes arsimimit të mesëm me një përvojë bazike në fusha të caktuara. Puna kryhet brenda udhëzimeve, procedurave të cilat janë të detajuara dhe në mbikëqyrjen e eprorit ose zyrtarit të nivelit të lartë profesional.

Përfshin pozitat me këto emërtesa:

Emërtesat e pozitave për këtë klasë përcaktohen në pajtim me Katalogun e Vendeve të Punës.

I. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Kjo klasë përfshin pozita për realizimin e detyrave për të cilat nevojiten njohuri/koncepte bazë nga fusha përkatëse e arsimimit apo shprehi bazë që merren zakonisht me arsimin Bachelor ose arsimim të mesëm me një përvojë bazike pavarësisht nga fusha apo specialiteti.
- Detyrat caktohen nga eprori ose një zyrtar i vjetër me përvojë së bashku me udhëzime të qarta, të detajuara, kryerja e të cilave kërkon që t'u jepet zgjidhje problemeve të thjeshta.
- Puna që kryhet në këto pozita është përgjithësisht me detyra rutinë brenda një funksioni për përmbushjen e të cilave nuk kërkohet përvojë e mëparshme pune.
- Puna konkrete në këto pozita kryhen në përputhje me udhëzime dhe/ apo procedura të cilat janë të mirë-detajuara dhe standarde.
- Puna në këto pozita kryhet nën mbikëqyrjen shumë të afërt të eprorit apo të zyrtarit të një klase më të lartë, i cili jep udhëzime verbale ose me shkrim.

Zyrtarët në këto pozita këshillohen me eprorin për çdo paqartësi apo vështirësi të hasur gjatë punës, për realizimin e detyrave që përdoren.

II. Karakteristikat sipas faktorëve të klasifikimit:

- ***Niveli i rëndësisë*** - përfshin përgjegjësinë për zbatimin e duhur të metodologjisë së punës, procedurat dhe teknikat profesionale. Si rregull, përgjegjësi për zbatim të detyrave të mirë përcaktuara të punës dhe pa pasoja jashtë njësisë organizative.
- ***Niveli i lirisë së vendimmarrjes*** - përfshin punën në mbikëqyrjen e rregullt të zyrtarit të lartë dhe udhëzimet e tij për zgjidhjen e problemeve rutinë.
- ***Niveli i vështirësisë*** – përfshinë kryerjen e disa detyrave rutinë që kërkojnë zbatimin e metodologjisë së përcaktuar të punës, procedurave dhe teknikave profesionale.

III. Kërkesat (Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë) e përgjithshme të nevojshme:

- Njohuri bazike profesionale dhe mbështetëse specifike në fushën përkatëse të punës, të fituar përmes arsimimit dhe trajnimeve bazike.
- Aftësi për të kuptuar dhe zbatuar praktikat operative me procedurat standarde administrative/teknike në një fushë të caktuar.
- Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative/teknike në një fushë të caktuar.
- Aftësi për të punuar me vetë iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara.
- Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët.
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point).

IV. Kërkesat e përgjithshme formale:

- a) Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve.
- b) Kualifikime të posaçme formale:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase.
- c) Përvoja e punës e kërkuar:** Nuk kërkohet.

Shtojca Nr. 2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm.

| Kodi i Grupit Tip | Emri i Grupit Tip | Fusha e kërkuar e arsimit |
|--------------------------|---|---|
| 1. Gr. | Specialist ligjor | Juridik. |
| 2. Gr. | Specialist financiar | Ekonomik, specialist finance apo kontabilitet. |
| 3. Gr. | Specialist i buxhetit | Ekonomik, specialist finance apo kontabilitet. |
| 4. Gr. | Specialist i ekonomisë | Ekonomik (pavarësisht nga specializimi). |
| 5. Gr. | Specialist i prokurimit publik | Ekonomik (pavarësisht nga specializimi)/Juridik dhe Administratë Publike. |
| 6. Gr. | Specialist i auditimit të brendshëm | Ekonomik, specializimi financa dhe/apo kontabilitet, Juridik, Administratë Publike. |
| 7. Gr. | Specialist i burimeve njerëzore | Juridik /Ekonomik /Psikologji (pavarësisht nga specializimi), Administratë Publike, Pedagogji, Gjuhët e huaja përkatëse |
| 8. Gr. | Specialist i përgjithshëm i shkencave politike | Shkenca Politike/ Administratë Publike /Politika Sociale/Juridik. |
| 9. Gr. | Specialist i arkiv- dokumentacionit | Juridik/Histori/Letërsi/Arkivistikë/Orientalistikë, Antropologji, Ballkanistikë. |
| 10. Gr. | Specialist i marrëdhënieve me publikun dhe informimin | Gazetari/Shkenca Komunikimi, Gjuhë dhe Letërsi, Marrëdhënie me Publikun, Marketing. |
| 11. Gr. | Specialist i përgjithshëm i tatim-taksave apo mbledhjes së të ardhurave | Juridik/ Ekonomik (pavarësisht nga specializimi). |
| 12. Gr. | Specialist i përgjithshëm i shërbimeve sociale | Psikologji/ Sociologji, Punë Sociale, Logoped. |
| 13. Gr. | Specialist i shkencave natyrore | Biologji, Zoologji, Agrikulturë, Hortikulturë, Pylltari, Gjeografi, Ekologji dhe Mjedis. |
| 14. Gr. | Specialist i shkencave shoqërore | Juridik, <u>Ekonomik</u> (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, |

| | | |
|----------------|---|---|
| | | Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale. |
| 15. Gr. | Specialist i shkencave politike | Histori /Filozofi/Sociologji, Shkenca Politike. |
| 16. Gr. | Specialist i përgjithshëm i inxhinierisë (duke përjashtuar elektro-teknologjinë) | Inxhinieri, me përjashtim të Inxhinierisë Elektro-Teknologji. |
| 17. Gr. | Specialist i shkencave të inxhinierisë së elektro-teknologjisë | Inxhinieri Elektronike, Elektronike dhe e Telekomunikimit. |
| 18. Gr. | Specialist i përgjithshëm i shëndetit/mjekësisë | Mjekësi e Përgjithshme, Mjekësi tjetër dhe Menaxhim Mjekësor. |
| 19. GR. | Specialist i teknologjisë informative | Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakulteti i Elektroteknikës. |
| 20. Gr. | Specialistë i përgjithshëm i trashëgimisë kulturore | Histori dhe Arkeologji, Etnologji, Antropologji, Orientalistikë, Letërsi, Arkitekturë. |
| 21. Gr. | Specialist i fizikës | Fizikë. |
| 22. Gr. | Specialist i meteorologjisë | Meteorologji, Fizikë, Gjeografi, Bujqësi. |
| 23. Gr. | Specialist i kimisë | Kimi, Kimi Industriale, Inxhinieri Kimike. |
| 24. Gr. | Specialist gjeolog dhe i gjeofizikës | Gjeologji, Gjeofizikë, Inxhinieri Gjeologjike/Gjeologji Inxhinierie dhe Hidrogjeologji. |
| 25. Gr. | Specialist i hidrologjisë | Shkencat Inxhinierike/Hidroteknike, Gjeologji, Hidrogjeologji, Gjeografi. |
| 26. Gr. | Specialist i cilësisë së ajrit | Kimi, Kimi Industriale/Teknologji e Përgjithshme, Inxhinieri Kimike/inxh.i Teknologjisë së Përgjithshme. |
| 27. Gr. | Specialist i matematikës | Matematikë. |
| 28. Gr. | Specialist i statistikës | Matematikë, Ekonomi, Gjeografi. |
| 29. Gr. | Specialist i biologjisë dhe botanikës | Biologji/Botanikë/Prodhim Bimor/Agronomi. |
| 30. Gr. | Specialist i zoologjisë dhe zooteknikës | Zooteknikë. |
| 31. Gr. | Specialist i bujqësisë, pyjeve dhe tokës | Agronomi/ Pylltari/Hortikulturë/Shkencat e Tokës. |
| 32. Gr. | Specialist i përgjithshëm i mjedisit | Inxhinieri Mjedisi/ Mjedisi/ Kimi e Përgjithshme, Ekologji dhe të ngjashme. |
| 33. Gr. | Specialist i cilësisë së dheut | Kimi, Kimi Industriale/Teknologji e Përgjithshme, Inxhinieri Kimike/inxh.i Teknologjisë së Përgjithshme, Bujqësi. |
| 34. Gr. | Specialist i inxhinierisë industriale | Inxhinieri Meteorologjike, Inxhinieri Industriale. |
| 35. Gr. | Specialist i inxhinierisë së ndërtimit | Inxhinieri Ndërtimi, Inxhinieri Civile. |
| 36. Gr. | Specialist i inxhinierisë mekanike | Kimi, Inxhinieri Kimike. |

| | | |
|----------------|--|---|
| 37. Gr. | Specialist i inxhinierisë minerare | Metalurgji Ekstraktues/ Inxhinier për Miniera/ Inxhinier për nxjerrjen e naftës dhe gazit natyror, Inxhinier i Xehetarisë, Inxhinier i Gjeologjisë. |
| 38. Gr. | Specialist i inxhinierisë elektrike | Inxhinieri Elektrike, Energjetike. |
| 39. Gr. | Specialist i inxhinierisë elektronike | Inxhinieri Elektronikë, Mekatronikë dhe Robotikë. |
| 40. Gr. | Specialist i inxhinierisë së telekomunikacionit | Inxhinieri e Telekomunikacionit. |
| 41. Gr. | Specialist i arkitekturës | Arkitekturë. |
